



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:059849

Datë: 30.01.2023

Numri i dokumentit: 03917289

C.nr.174/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, me bashkëpunëtorin profesional Liman Javori, në çështjen juridike të paditësit Sh. K. dhe H. K., që të dy nga fshati Bubavec, Komuna e Malishevës, të cilet i përfaqëson avokat N. K. nga Malisheva, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë (shujtës), vlera e kontestit 600,00 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë **30.01.2023** merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve Sh. K. dhe H. K., që të dy nga fshati Bubavec Komuna e Malishevës, ashtu që **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë (shujtës) paditësve t'ua paguajë:

- Paditësit **Sh. K.** shumën e përgjithshme prej **340.00** (treqind e katërdhjetë) **€uro**, në të cilën llogariten nga 2 (dy) Euro për 170 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej datës 17.04.2017 e deri me datë 15.03.2018, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë data 26.03.2021, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- Paditësit **H. K.** shumën e përgjithshme prej **260.00** (dyqind e gjashtëdhjetë) **€uro**, në të cilën llogariten nga 2 (dy) Euro për 130 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej datës 17.04.2017 e deri me datë 05.01.2018, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë data 26.03.2021, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësit t'ua paguaj shumën prej 333,00 Euro, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit Sh. K. dhe H. K., që të dy nga fshati Bubavec, Komuna e Malishevës, të cilët i përfaqëson avokat N. K. nga Malisheva, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kontest pune – kompensim i shpenzimeve të ushqimit.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre av. N. K., në padi dhe në precizimin e kërkespadiës të datës 14.12.2022 kanë theksuar se: paditësi Sh. K. ishte i punësuar në pozitën mësimdhënës pranë Shkollës Filllore të Mesme të Ulët SHFMU "Dëshmorët e fshatit Bubavec" në Bubavec, ndërsa paditësi H. K. ishte i punësuar në pozitën mësimdhënës pranë SHMP "Lasgush Poradeci" në Kijevë, Komuna e Malishevës. Paditësi Sh. K. për periudhën prej datës 17.04.2017 e deri me datë 15.03.2018 ka 170 ditë të vajtjes në punë, ndërsa paditësi H. K. për periudhën prej datës 17.04.2017 e deri me datë 05.01.2018 ka 130 ditë të vajtjes në punë dhe për këtë periudhë nuk janë kompensuar nga e paditura me shpenzime të ushqimit. E paditura ka detyrim që në pajtueshmëri me nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit paditësve të ua paguaj shpenzimet e ushqimit gjatë vijueshmërisë në pune, duke llogaritur për secilën ditë nga dy euro. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar në shumën prej 600.00 Euro, duke kërkuar aprovimin për paditësin Sh. K. në shumën prej 340.00 ndërsa për paditësin H. K. shumën prej 260.00 Euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% prej momentit të ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifës së avokatëve në shumën prej 333.00 Euro, duke përfshirë 156 euro në emër të përpilimit të padisë, 156 euro në emër të precizimit dhe 21 euro në emër të taksës për padi.

E paditura me datë 05.12.2022 ka paraqitur përgjigje në padi, sipas të cilës ka theksuar se e konteston vlerën e kërkesëpadisë, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi që palët të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjithë kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me datë 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate. Po ashtu MAPL ka bërë njoftim për kryetarët e Komunave me datë 22.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT, për mungese të bazës ligjore të saj. Kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT. E paditura nuk ka legjitimitet pasiv në këtë procedure, por këtë legjitimitet e ka MASHT. I propozojmë gjykatës që ta refuzon padinë e paditëses si të pa bazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës – MASHT.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve nuk është kontestues fakti se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë: paditësi Sh. K. ishte i punësuar në pozitën mësimdhënës pranë Shkollës Filllore të Mesme të Ulët SHFMU "Dëshmorët e fshatit Bubavec" në Bubavec, ndërsa paditësi H. K. ishte i punësuar në pozitën mësimdhënës pranë SHMP "Lasgush Poradeci" në Kijevë, Komuna e Malishevës deri në pensionim.

Nga Vërtetimi Nr.31/222 i datës 07.04.2022, i lëshuar nga S SHMP "Lasgush Poradeci" në Kijevë, Komuna e Malishevës dhe Vërtetimi Nr.360/1 të datës 05.04.2022 i lëshuar nga SHFMU "Dëshmorët e fshatit Bubavec" – Bubave, Komuna e Malishevës, vërtetohet fakti se paditësi Sh. K. për periudhën prej datës 17.04.2017 e deri me datë 15.03.2018 ka 170 ditë pune, ndërsa paditësi H. K. për periudhën prej datës 17.04.2017 e deri me datë 05.01.2018 ka 130 ditë pune.

Ligji i Punës Nr.03/L-212, neni 90 par.4 dhe 5 e përcaktojnë se *"4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"* dhe *"5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive"*.

Sipas nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, është paraparë se: 35.7 *"Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore"*.

Në pajtueshmëri me dispozitat e lartëcekura, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se paditësi Sh. K. për periudhën prej datës 17.04.2017 e deri me datë 15.03.2018 ka 170 ditë pune dhe i takojnë nga dy euro për secilën ditë të punës në emër të shpenzimeve të ushqimit ($170 \times 2 = 340.00$ euro) e që është shuma prej 340.00 euro, ndërsa paditësi H. K. për periudhën prej datës 17.04.2017 e deri me datë 05.01.2018 ka 130 ditë pune dhe i takojnë nga dy euro për secilën ditë të punës në emër të shpenzimeve të ushqimit ($130 \times 2 = 260.00$ euro) e që është shuma prej 260.00 euro. Sipas këtyre dispozitave të Kontratës Kolektive punëdhënësja e fundit është ajo që i paguan shpenzimet e ushqimit për punëtorët e saj. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtave) në punë.

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se *"Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë"*.

Bazuar në nenin 398 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore pasi që vlerësoi se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit ishte qartazi e themeltë pasi që ka bazë në dispozitat e ligjore të përmendura më lartë, ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës në përgjigje në padi gjykata vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike me të cilën do të duhej të refuzohej kërkesëpadia e paditësit. Pretendimet e të paditurës se i mungon legjitimiteti pasiv në procedurë janë të pabazuara, me arsyetimin se Kontratën Kolektive të Arsimit e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë. Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit (mësimdhënësve) dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarit e saj në arsim. Pretendimet e të paditurës se Kontrata Kolektive është

shkëputur dhe nuk prodhon efekt juridik nuk kanë mbështetje ligjore, për faktin se Kontrata Kolektive ka afat 3 vjeçar konform nenit 90 par.4 të Ligjit të Punës, ndërsa zbatimi i saj e ka të caktuar periudhën kohore prej 3 vitesh nga momenti i hyrjes në fuqi.

Gjykata analizoi edhe pretendimet tjera të të paditurës, mirëpo vlerësoj se të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me kamatën prej 8 % gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, dhe e njëjta llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 333.00 Euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 156.00 €, në emër të precizimit të kërkesëpadisë shumë prej 156.00 €, kurse në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 21 Euro.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 398 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.174/2021, me datë 30.01.2023.

**B. Profesional
Liman Javori**

**G j y q t a r i,
Besmir JUNIKU**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa parashtrohet në këtë gjykatë, për Gjykatën e Apelit - Prishtinë.